



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 805 Prot.

Tiranë, më datë 08.06 2021

**VENDIM**  
**Nr. 276, datë 08.06.2021**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 08.06.2021:

**VENDOSI:**

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për objektin *Projekt-Ide “Restaurimi dhe Rikualifikimi urban i zonës perspektive TID të gjendur në Parkun Arkeologjik të Durrësit”*, me aplikues Illyrian Consulting Engineers, zhvillues Fondin Shqiptaro – Amerikan të Zhvillimit (AADF), projektues restaurator Genc Samimi:
  - Plani prishjeve të propozuara në këtë projekt të jetë në përputhje me PDyV-në për Zonën e Re për Zhvillim, Zona 5, Bashkia Durrës, të miratuar;
  - Çdo objekt i evidentuar për prishje, i cili nuk është parashikuar sipas PDyV-së së sipërcituar, të plotësohet me një raport të detajuar duke specifikuar dhe metodologjinë e prishjeve;
  - Çdo objekt i evidentuar për ndërhyje duhet të plotësohet më material grafik;
  - Të sillen variant tjetër për sa i përket hijëzuesit përgjatë bulevardit, i cili duhet të ketë një impakt minimal në peizazhin urban.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

